

2. JETA NË FAMILJE



Fëmijët lindin e rriten në familjen e vet. Familja është rrethi ku fëmijët gjejnë dashurinë, ngrohtësinë e sigurinë për jetë. Ndikimi i familjes në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve është i madh. Familja me mënyrën e saj të trajtimit dhe të edukimit të fëmijëve ndikon në formimin dhe zhvillimin e karakterit të tyre. Madhësia e familjes, niveli i shkollimit të prindërve, por edhe kushtet në të cilat rriten fëmijët ndikojnë shumë në personalitetin dhe karakterin e tyre.

Por familja është edhe rrethi, ku fëmijët në fazën e pubertetit kanë ndonjëherë keqkuptime e mosmarrëveshje. Njohja me këto keqkuptime e mosmarrëveshje na mundëson të gjykojmë drejt dhe me arsye, në mënyrë që t'i zvogëlojmë apo t'i eliminojmë ato në tërësi.

A duhet ta bëjnë prindërit këtë?

Një ditë kur Valoni u kthye nga shkolla e gjeti një letër mbi tryezën e tij të punës. Ishte letra që ia kishte dërguar një shoqe, por letra ishte e hapur. Valoni paksa i zemëruar hyri në kuzhinë, ku ishte nëna dhe e pyeti atë për letrën. Ajo iu përgjigj: „Mos e merr për të keq, djali im. Ne jemi prindërit e tu dhe nuk duam që ti të mbajsh fshehtë diçka prej nesh“. Valoni i tha se tashi është në klasën e nëntë dhe prindërit nuk kanë të drejtë t'ia hapin letrat.

A mund të vonohem sa dua unë?

Mimoza ka dalë me shoqet në qytet. Duke shëtitur i kishte kaluar koha pa e vërejtur. Akrepat po i afroreshin orës 20, aq sa kishte marrë leje nga prindërit për të qëndruar në qytet. Asaj tash i duhej edhe gjysmë ore deri në shtëpi, prandaj filloi të brengosej. Prapë do të kem probleme me prindërit. Kjo nuk është e drejtë. Pse shoqet e mia guxojnë të rrinë më gjatë në qytet, mendonte ajo, duke u ngutur për në shtëpi.

A duhet prindërit të brengosen për suksesin tim?

Teona dhe Albani janë motër e vëlla binjakë dhe shkojnë në klasën e tetë. Teona është e dhënë pas mësimit dhe dallohet në klasën e vet si nxënëse e mirë dhe e sjellshme. Edhe i vëllai Albani një kohë ishte i mirë, por kohën e fundit suktesi i tij në mësim nuk është si më parë. Këtë e kuptuan prindërit kur ishin në takim me kujdestarin e klasës. Në fakt prindërit kishin dyshuar se ai nuk mund të jetë si më parë në mësim, sepse e kishin vërejtur se kohën më të madhe e kalonte me kompjuter- në facebook. Gjithnjë e më shpesh në mbrëmje deri vonë rrinte duke shikuar televizorin. Pastaj kohën e fundit ditët e fundjavës i kalonte me shokët e vet në qytet. Nga takimi me kujdestarin e klasës prindërit ia kufizuan Albanit kohën e qëndrimit para kompjuterit, ia hoqën televizorin nga dhoma e fjetjes dhe ia caktuan kohën e qëndrimit me shokët në qytet. Albani mendonte pse shokët e tij nuk i kanë këto kufizime, edhe pse kanë sukses si ai. Prindërit s'kanë pse të brengosen për suksesin tim, sepse unë tash jam rritur, mendon ai.

- 1. Lexoni tekstet në korniza dhe komentoni ato!**
- 2. Gjikoni për çdo rast veç e veç dhe shpreni mendimin tuaj para shokëve e shoqeve të klasës!**
- 3. Kujt i jepni të drejtë? Pse?**
- 4. Bisedoni në klasë: Cilët faktorë ndikojnë në mosmarrëveshjet në mes të fëmijëve dhe të prindërve?**
- 5. Merrni nga një letër (të jenë të njëjta dhe të shpërndara nga mësues/i/ja) dhe shkruani përvojat tuaja me prindërit. Cekni mosmarrëveshjet apo keqkuptimet eventuale. Pasi të keni mbaruar punë, i mblidhni ato në një vend të caktuar. Për të qenë më intime dhe më reale letrat duhet të jenë anonime (pa emër).
Tash çdonjëri merr nga një letër të shkruar dhe e lexon me zë para klasës. Rastet tipike të keqkuptimeve dhe të mosmarrëveshjeve shënohen nga një nxënës në tabelë. Pastaj çdo nxënës/e i shkruan ato brenda kësaj kornize. Bisedoni dhe gjykoni drejt për to.**
- 6. Bisedoni në klasë se kush tjetër pos familjes ndikon në formimin e personalitetit të njeriut!**
- 7. Kënga në faqen vijuese i kushtohet nënës. Mësoni edhe ju ta këndonit për nënën tuaj!**